



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

Nr. 10 , datë 9 . 4 .2019

**MBI**

**“PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E RI-SHPËRNDARJES SË GRANTIT TË  
AKORDUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË,  
SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE DHE PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E  
REGJISTRIT TË PROKURIMEVE, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN  
KALENDARIK 2019”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve Znj. Alma Sinanaj “Propozim për shpërndarjen e Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe regjistrin e prokurimeve”, pasi e diskutoi me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Propozimin për miratimin e ri-shpërndarjes së Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe propozimin për miratimin e regjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2019.
2. Ri-shpërndarjen e Grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpërndarjen e të ardhurave dhe regjistrin e prokurimeve në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2019, sipas materialit, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve për miratim.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

